



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 283, Datë 17.12.2020

**PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT**

Në mbështetje të nenit 149/ç, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, nenit 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 189/1/a, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 8, të Rregullores së KLP-së “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, pasi u njoh me kërkesën me nr. Prot 1540, datë 30.10.2020 dhe Relacionin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokuroren Eliona Elezi si pedagoge e jashtme në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, për vitin akademik 2020-2021, në lëndën “Procedurë penale e avancuar”, për kategorinë “seminare”, gjithsej 60 orë të cilat do të zhvillohen on-line, të ndara 4 orë në çdo javë, veprimtari e cila do të kryhet jashtë orarit të punës.
2. Të njoftohen për këtë vendim znj. Eliona Elezi dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**KRYETARI**  
**GENT IBRAHIMI**

**ANËTAR**  
**BEJAR SHESHI**

**ANËTARË**  
**ESMERALDA KESHI**

**ZV/KRYETARI**  
**ALFRED BALLA**

**ANËTAR**  
**KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR  
SANDËR BECI**



**ANËTARE  
NURIHAN SEITI**



**ANËTAR  
VATË STAKA**



**ANËTAR  
TARTAR BAZAJ**

